

# Dobi dhe Farime të përzgjedhura të Selefizmit

Shkëputur nga Letra e Imamit, Ebu Nasr 'Ubejdullah es-Sixhzi,  
drejtuar Popullit të Zubejdit, në refuzimin e atyre që mohojnë  
Shkronjat dhe Zërin



*Përgatiti: Shejkh Khalid Ibn Dahwij adh-Dhufejri*



© Selefi.org

## Hyrje:



Lavdia i takon Allahut; salati dhe selami qoftë mbi të Dërguarin e Allahut, mbi Familjen e tij, Shokët e tij dhe të gjithë ata që ndjekin Udhëzimin e tij. E më pas:

Vërtet, e lexova letrën e mrekullueshme, e cila është në një gradë të lartë, e shkruajtur nga Ebi Nasr es-Sixhzi, Allahu pastë mëshirë për të, në refuzimin e atyre që mohojnë shkronjat (*el-Harf*)<sup>1</sup> dhe zërin (*es-Sent*)<sup>2</sup> dhe pushë se ajo përmbante parime madhështore të Selefizmit dhe baza të Menhexhit. Pata dëshirën që t'i mbledh disa prej tyre në mënyrë që Pasuesi i Sunetit të përfitojë dhe të kuptojë se këto ishin parimet të cilat kanë ndjekur Selefët e vjetër. Ata kanë këshilluar me këto parime deri në kohën tonë; veçanërisht për shkak të pranisë së një numri të madh bidatçijsh që gjenden mes rradhëve tona, të cilët kanë shkaktuar çoroditje për shumë nga këto parime.

Atëherë, përpara se të fillojmë, unë po ju prezantoj këtë Imam:

---

<sup>1</sup> Nga Ibn 'Abbasi (*radij-Allahu 'anhuma*) i cili ka thënë: "Kur Xhibrili u ul me Pejgamberin (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*), ai dëgjoi një tingull të çuditshëm që erdhi nga lartë, kështu që ai (Xhibrili) ngriti kokën lart dhe tha: "Kjo është një derë në qiell që është hapur sot, e cila nuk është hapur asnjëherë përveç se në këtë ditë." Një melek zbriti prej saj dhe ai (Xhibrili) tha: "Ky është një melek që ka zbritur në tokë, i cili nuk ka zbritura asnjëherë më parë përveç se sot." Ai e pëshëndeti atë dhe tha: "Unë po të përgëzoj me dy drita që kam ardhur për t'i dhënë ty, të cilat nuk i janë dhënë askujt tjetër para teje; el-Fatiha dhe ajeti i fundit i Bekares. Për çdo shkronjë që do të lexosh prej tyre, ty do të dhurohet." Transmetuar nga Muslimi (n. 806), Nesa'iu (2/138), Hakimi (1/558-559) dhe Ibn Hibbani (n. 766). 'Abdullah Ibn Mes'udi ka thënë: "Mësojeni Kur'anin. Vërtet, për çdo shkronjë që shkruhet nga ai fitohen dhjetë shpërblime dhe fshihen dhjetë gjynahe. Unë nuk them se *Elif*, *Lam*, *Mim* janë dhjetë, por them se *Elifi* është dhjetë, *Lami* është dhjetë dhe *Mimi* është dhjetë." **Sahijh:** transmetuar nga Ibn Ebi Shejbe (10/461). Shu'ajb Ibn Habhab ka thënë: "Sa herë që ndonjë njeri lexonte Kur'an me Ebul-'Alijen dhe nuk lexonte ashtu si ai, atëherë Ebul-'Alija i thoshte: "Kurse unë do ta lexoj atë si filani." Ai tha: "Unë ia përmenda këtë Ibrahim en-Nekha'it dhe ai tha: "Po shoh se Shoku yt e paska dëgjuar që kushdo që mohon një shkronjë të vetme prej tij, atëherë ai e ka mohuar atë të tërin." Transmetuar nga Ibn Ebi Shejbe (10/513-514) dhe Ibn Xheriri në *Tefsirin* e tij (n. 56).

<sup>2</sup> Imamët e Selefëve e kanë pohuar zërin e Allahut (*es-Sent*). Ka thënë 'Abdullah Ibn Ahmed Ibn Hanbel: E pyeta babain tim - *rahimehullab* - për ata njerëz që thonë "Kur Allahu i foli Musait (*alejhis-selam*), Ai nuk foli me zë." Kështu, babi im tha: "Sigurisht! Vërtet, Zoti yt (*Azxe ue Xhel*) foli me zë. Ne i transmetojmë këto hadithe ashtu siç kanë ardhur." Transmetuar nga 'Abdullahu në *es-Sunen* (n. 533). Imam Ebu Bekr el-Meruedhi, shoku i Ahmed Ibn Hanbelit, ka thënë: E dëgjova Ebu 'Abdullahun kur atij i thanë se 'Abdul-Uehabi kishte folur e kishte thënë: "Kushdo që pretendon se Allahu i foli Musait pa zë, atëherë ai është një Xhehmi dhe një armik i Allahut e armik i Islamit." Kështu, Ebu 'Abdullahu tha: "Sa e bukur është kjo që ka thënë ai, Allahu e faltë." Transmetuar nga Khalali nga el-Meruedhi. [Shiko *Dar'ut-Te'arud*, 2/37-39 të Ibn Tejmijes]. 'Abdullah Ibn Ahmed ka thënë: "E pyeta babain tim: "Vërtet, ka nga ata që thonë se Allahu nuk i foli Musait me zë." Kështu, ai tha: "Këta janë Xhehmitë heretikë, ata përdorin vetëm *ta'til* (mohimin)", dhe pastaj përmendi transmetimet që kundërshtonin deklaratën e tyre." Shiko *Mexhmu'ul-Fetana* (12/368).

## *Imam Ebu Nasr Ubejdellah es-Sixhzi*



### *Emri dhe prejardhja e tij:*

Ai është Imami, dijetari i madh, Ebu Nasr ‘Ubejdullah Ibn Se’id Ibn Hatim el-Uejili el-Bekri es-Sixhzi. Fjala es-Sixhz vjen është shkurtimi i emrit të prejardhjes së tij që është Sixhistani.

### *Mësuesit e tij:*

Nga mësuesit e tij më të famshëm përmendim:

- 1- Ebu Abdullah el-Hakim en-Nisaburi (v.405H)
- 2- Ebu Ahmed el-Fardi ‘Ubejdullah el-Mukri
- 3- Ebul-Hasen Ahmed el-Muxhbir Musned Bagdad

### *Studentët e tij:*

Nga studentët e tij më të famshëm përmendim:

- 1- Hafidhi, Muhadithi preçiz, Ebu Is`hak Ibrahim Ibn Se’id en-Nu`man
- 2- Hafidhi, Ebul-Fadl Xha’fer Ibn Jahja et-Temimi, i njohur ndryshe si Ibn Hakak
- 3- Hafidhi, ‘Abdul-‘Azijz Ibn Muhamed en-Nakhshabi

### *Shkrimet e tij:*

- 1- *el-Ibane fij Radd ala ez-Za’igijn fij Mes’eletil-Kur’an*, vepër e cila ka humbur
- 2- Letra që shkroi për popullin e Zubejdit duke i përgënjeshtuar ata që refuzonin *el-Harf* dhe *es-Seut* (shkronjën dhe zërin, lidhur me Kur'anin).
- 3- *Rinajetul-Ebna ‘amil-Aba’*

Vdekja e tij:

Ai vdiq në Mekke në vitin 444H, sipas mendimit më të saktë.

Lavdërimi i dijetarëve për Imam Siçxin:

Studenti i tij, en-Nakhshabi, ka thënë: “Dijetari, Hafidhi, Shejkhu preciz, transmetuesi besnik dhe i besueshëm nga Ehli-Suneti.”

Imam Dhehebi ka thënë: “Imami, Dijetari, Hafidhi i specializuar, Shejkhu i Sunetit, Ebu Nasr Ubejdullah Ibn Se’id... Shejkhu i Haramit (Mekkes), autori i *el-Ibanetul-Kubra* për të vërtetën që Kur'ani nuk është i krijuar. Ky është një vëllim i madh që vërteton dijen e këtij njeriu rreth shkencës së ethereve (gjurmëve të Selefëve).”

[*Si'jer Alamun-Nubela*, 17/654]

Kjo biografi është shkëputur dhe përshtatur nga parathënia e verifikimit të këtij libri nga Dr. Ba Kerim. Ai që dëshiron informacion të mëtejshëm le t'i referohet atij libri.

## *Parimet dhe Dobitë e përzgjedhura:*



### *[1] Kush janë Ehli-Suneti?*

Tha Imam es-Sixhzi - *rahimehullab* - në Letrën që i dërgoi Popullit të Zubejdit (*Risaleti ila Ehli-Zubejd*, fq. 99): “Ehli-Suneti janë ata që besojnë me bindje të thellë atë çfarë u transmetuan Selefus-Salih - *rahimehumullab* - nga i Dërguari (ﷺ) apo nga Sahabët (رضي الله عنهم) rreth asaj që nuk ka ardhur ndonjë tekst nga Kur'ani dhe as nga i Dërguari (ﷺ).”

### *[2] Nga Shenjat e Njerëzve të Bidatit është se fjalët e tyre nuk pajtohen me Argumentet e Kur'anit dhe Sunetit:*

Tha Imam es-Sixhzi - *rahimehullab* - (fq. 100-101): “Është detyrë për çdo njeri që pretendon Sunetin, që çdo gjë që ai thotë ta mbështesë me transmetim të saktë. E nëse vjen me të, atëherë njihet vërtetësia e tij dhe fjala e tij pranohet. Dhe nëse ai nuk është i aftë që të japë një transmetim nga Selefët për atë çfarë thotë, atëherë na bëhet e ditur se ai është një bidatçi i devijuar. Ai nuk meriton që të dëgjohej dhe as nuk duhet të debatohet me të për ato çfarë thotë ai. Dhe dihet se kundërshtarët tanë, *mutekeliminët* (filozofët) - se ata kanë rënë në pajtim që të qëndrojnë larg teksteve (të Kur'anit dhe Sunetit) dhe të mos flasin me to. Por, fakti që ata i sprovajnë njerëzit e teksteve është i qartë dhe fakti që ata përpiqen t'i largojnë njerëzit nga ata që ndjekin tekstet (e Kur'anit dhe Sunetit) është i qartë. Kurse librat e tyre nuk përmbajnë asnjë *isnad* (zinahir transmetimi nga Pejgamberi (ﷺ) apo nga Selefët (رضي الله عنهم).”

[3] *Kushdo që thotë se nuk është e detyrueshme dija që gjendet në Transmetimet Ahad dhe e baxon Medh'hebin e tij mbi logjikën e tij, atëherë ai është Bidatçi:*

Tha Imam es-Sixhzi - *rahimehullab* - (fq. 101): “Dihet se ai që flet me atë që është në transmetimet e sakta nga i Dërguari (ﷺ) nuk duhet quajtur Bidatçi. Por, ai duhet të quhet *Sunij* dhe *Muttabi'* (Pasues i Gjurmëve të Selefëve). Kurse ai që flet me fjalët e tij dhe pretendon se ato janë rezultat i logjikës së tij dhe se nuk ia vlen që të merret në konsideratë hadithi që e kundërshton atë, për shkak të qëndrimit që mban ai rreth transmetimeve Ahad dhe mendimit të tij se nuk është e detyrueshme dija që kanë ato, ndërsa dija e logjikës së tij është e detyrueshme, atëherë ky njeri meriton të quhet bidatçi.”

[4] *Kur një Dijetar thotë për veten e tij se është nga Ehli-Suneti dhe se Kundërshtarët e tij janë Njerëzit e Bidatit, atëherë ai nuk po i bën Texkije vetes dhe kjo nuk duhet të gortohet:*

Tha Imam es-Sixhzi - *rahimehullab* - (fq. 101): “Dhe kushdo që ka mësuar sadopak ka aftësi që të bëjë dallim ndërmjet nesh dhe kundërshtarëve tanë duke menduar thellë në fillimin e këtij studimi. Kështu, ai do ta marrë vesh se ne jemi Ehli-Suneti e jo ata; dhe se bidatçijtë janë kundërshtarët tanë e jo ne.”

[5] *Njerëzit e Bidatit shfaqin atë që nuk e besojnë në të vërtetë, si Mashtrim dhe Thurth për të devijuar njerëzit që kanë mendim të mirë për ta:*

Tha Imam es-Sixhzi - *rahimehullab* - (fq. 122) ndërsa flet rreth Esh'arive: “Kurse ajo që shfaqin ata, e cila bie në kundërshtim me atë që besojnë ata në të vërtetë, sikurse është e praktika e zindikëve, atëherë kjo ka të bëjë me pohimin e tyre se Allahu i Lartësuar u ngrit lart (*istena*) mbi Arsh. Sidoqoftë, prej besimit të tyre është se nuk lejohet që Allahu të përshkruhet duke pohuar se Ai është mbi qiej, as që Ai është në tokë, as që Ai është mbi Arsh dhe as që Ai është lart.”



[6] *Asnjë Bidatçi nuk duhet thirrur 'Imam,' megjithëse ai mund të ketë dije të madhe; Kërkesa e Vetme për këtë është se ai duhet të jetë Ndjekës i Menheshit, Pasues i Selefëve.*

Tha Imam es-Sixhzi - *rahimebullab* - (fq. 130): “Dhe nëse është ajo kohë kur fjala e atij që e refuzon Allahun e Lartësuar është e pranuar dhe ai konsiderohet si Imam për atë çfarë thotë, atëherë dijeni se kjo është një kohë e vështirë. Dhe prej Allahut kërkohet ndihma.”

Tha Imam es-Sixhzi - *rahimebullab* - (fq. 207): “Dhe nëse dikush ka fituar epërsi në këto fusha të dijes duke studiuar me një njeri që ka dije të gjerë dhe ai është një pasues i Selefëve dhe qëndron larg nga bidatet, atëherë atij duhet t’i jepet grada e Imamit. Ai e meriton që t’i merret dija, të pyetet dhe t’i zihet besë.”

Imam es-Sixhzi - *rahimebullab* - përmendi disa nga Imamët e Selefëve dhe pastaj tha për ta (fq. 214): “Dhe ata ishin Imamët e dijes; ata njiheshin për ndjekjen e Sunetit (*ittiba*). Prej tyre merrej dija ndërsa në kohën e tyre kishte Dijetarë që kishin epërsi në fushat e diturisë dhe njerëzit ndiqnin medh’hebin e tyre. Sidoqoftë, ata ranë në disa bidate, qoftë bidati i Kaderit<sup>3</sup>, bidati i Shijave<sup>4</sup> apo Irxha’ja<sup>5</sup>. Kjo gjë u mor vesh, kështu që pozita që kishin ata ra para Njerëzve të Hakut.

---

<sup>3</sup> Ata janë **Kaderitë**, pasuesit e Ma’bad el-Xhuhejnit. Besimi i tyre përfshinte: se Allahu nuk ka dijeni për gjithçka, derisa ato të vijnë në ekzistencë; se njerëzit janë ata që i krijojnë vetë veprat e tyre e jo Allahu, mohojnë Dënimin në Varr dhe e mohojnë hadithin e saktë që të përdoret si argument në çështjet e Akijdes, përveç se atëherë kur ai ka ardhur në shumë rrugë të ndryshme transmetimi (*mutenuatir*).

<sup>4</sup> **Shijat** janë një sekt ekstremistësh të cilët refuzuan Zejd Ibn ‘Ali Ibnul-Husejn për shkak se ai nuk pranoi që të mallkonte Ebu Bekrin dhe ‘Umerin (رضي الله عنهما). Ata u prishën menjëherë në akide, moral dhe në të gjithë Fenë, ndërsa sot ata përfaqësohen nga Shijat *Ithna ‘Ashrije* të Iranit. Nga besimet e tyre të pabaza përmendim: ata i deklarojnë të gjithë Sahabët qafira, me përjashtim të tre apo pesë prej tyre; besojnë se Imamët e tyre kanë dije rreth Gajbit (të Fshehtës që e di vetëm Allahu), e konsiderojnë Imamatin si një nga pjesët kryesore të imanit (besimit) dhe pretendojnë se Kur’ani është i mangët.

<sup>5</sup> **Murrxi’at** janë ata që refuzojnë t’i pranojnë veprat si pjesë të Imanit dhe thonë se Imani është vetëm vërtetim i zemrës dhe thënie e gjuhës. Ekstremistët nga rradhët e tyre madje e kanë kufizuar Imanin vetën në besimin me zemër. Gjithashtu, ata mohojnë që Imani të shtohet apo të pakësohet.

Tha Imam es-Sixhzi - *rahimebullab* - (fq. 216): “Kurse sot, ai që njihet se është i paepur në ndjekjen e menhexhit dhe duket hapur epërsia e tij në fushat e diturisë që përmendëm, atëherë ai është një Imam i cili duhet të pasohet. Dhe kushdo që devijon nga shtegu dhe këshillohet me njerëzit e bidatit dhe filozofisë (*kelam*) dhe qëndron larg nga hadithi dhe njerëzit e tij, atëherë ai meriton që të bojkotohet dhe të braktiset edhe nëse ai ka epërsi në këto fusha të dijes.”

[7] *Sidoqoftë, sa më shumë që të fshihet një Bidatçi dhe të futet mes rradhëve të Ehli-Sunetit, aq më shumë dëm do të shkaktojë ai sesa Bidatçijtë që dalin sheshit me bidatet e tyre:*

Tha Imam es-Sixhzi - *rahimebullab* - (fq. 177-181): “Mu’tezilët<sup>6</sup> megjithë medh’hebin e ligë që kanë shkaktojnë më pak dëm tek njerëzit e thjeshtë të Ehli-Sunetit sesa të tjerët, sepse Mu’tezilët kanë një medh’heb që duket haptazi, kështu që ai nuk do të ketë rrënjë të fuqishme për të ardhmen (pra, ai nuk do të mbërrijë deri tek ata që do të vijnë më pas) dhe as nuk ka për t’i zënë ata. Në këtë mënyrë, medh’hebi i tyre është i njohur tek pjesa më e madhe e Muslimanëve, prandaj ata distancohen prej tyre dhe i konsiderojnë ata si armiq. Poashtu, edhe Kulabijet<sup>7</sup> dhe Esh’aritë i kanë

---

<sup>6</sup> **Mu’tezilët** janë një sekt që u shfaqën nga fundi i shekullit të dytë pas Hixhretit, kur ‘Amr Ibn ‘Ubejd dhe Uasil Ibn ‘Ata braktisën (*i’tizële*) Xhematin pas vdekjes së el-Hasen el-Basrit (v. 110H). Këta njerëz themeluan medh’hebin e tyre mbi pesë parime, të cilat ishin: [1] drejtësia (*el-‘adl*), [2] Teuhijdi, [3] zbatimi i kërcënimit të Allahut, [4] një gradë ndërmjet dy gradëve, [5] urdhërimi i të mirës dhe ndalimi i të keqes. Ata përzien në këto parime të vërtetën me të pavërtetën, ashtu sikurse veprojnë të gjithë Bidatçijtë.

Ata janë *mushebihinë* për sa i përket veprave, sepse ata i lidhin veprat e Allahut të Lartësuar me veprat e robërve të Tij. Kështu, ata i konsiderojnë veprat e mira që ka bërë robi si mirësia e Atij dhe çdo gjë e keqe që bën robi është e keqja e Atij. Ata i konsideronin gjërat të lejuara ose të ndaluara duke u bazuar mbi kijasin e tyre të mbrapshtë. Sipas tyre, Teuhijdi ishte nga parimet e mendjeve të tyre që nuk i njohin tekstet (e Kur’anit dhe Sunetit) përveç se si burim dytësor. Kështu që, nëse ata kërkojnë ndonjë argument nga tekstet, ata e përmendin atë vetëm si argument shtesë e jo si diçka të cilës mund t’i bazohesh. Pra, mu’tezilët kanë shumë devijime. Dhe midis tyre kishte të atillë që bënë përpjekje të mëdha në këtë jetë të bazuar mbi mendimet e tyre të devijuara, e megjithatë ata i konsideronin veprat e tyre si të mira. Shiko për më tepër: *el-Milel uen-Nihel* (1/43-46), *Sherbul-‘Akijdetit-Tabanije* (fq. 521-52), *el-Burhan fji Ma’rifeh ‘Aka’id Ehlil-Edjan* (fq. 27) dhe *Dhiker Medhabibil-Firak* (fq. 49) nga el-Jafi’i.

<sup>7</sup> **Kulabije** quhen pasuesit e ‘Abdullah Ibn Kulabit. Këta janë nga sektet e quajtura *Murxhi’atul-Ka’ile*, të cilët thonë se askush nuk do të hyjnë në Xhehenem përveç mosbesimtarëve. Kurse besimtarët nuk kanë për të hyrë fare në të edhe nëse ka gjynahe që



refuzuar haptazi Mu'tezilët dhe e kanë mbrojtur haptazi Sunetin dhe njerëzit e tij.” Pastaj, ai përmendi disa nga besimet e Ebul-Hasen el-Esh'ari dhe tha: “Poashtu, shumë prej atyre që janë në medh'hebin e tij flasin me atë çfarë thonë Ehli-Sunetit në përgjithësi. Pastaj, pasi i shpjegon dhe i shqyrton ato, ato përfundojnë tek thëniet e Mu'tezilëve. Kështu, ai që është injorant do ta pranojë atë që duket nga pamja e jashtme, por njeriu i ditur do të flasë për atë që është në dijeni. Prandaj, dëmi i tyre është më i madh sesa i Mu'tezilëve, sepse këta të fundit e kanë nxjerrë në shesh kundërshtimin që i bëjnë Ehli-Sunetit, kurse këta të parët (Esh'aritetë dhe Kulabitë) janë të fshehtë dhe përpiqen që të përzihen me njerëzit e Hakut.”

[8] *Nga Shenjat e Njerëzve të Bidatit është se ata i Shajnë Dijetarët e Sunetit:*

Tha Imam es-Sixhzi - *rahimehullab* - (fq. 185): “Disa nga pasuesit e tyre të devijuar kanë thënë “Nuk ka asnjë dallim midis Shujukhëve (Dijetarëve) të Hanbelive dhe Çifutëve, përveç një cilësie.” Dhe nuk ka dyshim se është vetëm një cilësi që i dallon këto dy grupe! Por, ajo nuk është ashtu siç mendojnë pasuesit e pafytyrë. Ky dallim i vetëm është se Hanbelitë janë në Islam dhe në Sunet, kurse Çifutët janë në Kufër (mosbesim) dhe Dalalet (humbje).”

[9] *Futja në Debate me Njerëzit e Bidatit përmban Çoroditje të pamasë:*

Tha Imam es-Sixhzi - *rahimehullab* - (fq. 100-101): “Është detyrë për çdo njeri që pretendon Sunetin, që çdo gjë që ai thotë ta mbështesë me transmetim të saktë. E nëse vjen me të, atëherë njihet vërtetësia e tij dhe fjala e tij pranohet. Dhe nëse ai nuk është i aftë që të japë një transmetim nga Selefët për atë çfarë thotë, atëherë na bëhet e ditur se ai është një

---

janë të mëdha. Ata kanë bazuar mbi këtë mendim parimin e tyre themelor se Imani është vetëm vërtetim (*tesdiq*) me zemër. Ata nuk thonë ashtu si Ehli-Suneti dhe Xhemati se Imani është besim me zemër, pohim me gjuhë dhe veprim me gjymtyrë. Kulabijet mohojnë që Allahu t'i ketë folur Musait (ﷺ), por thonë se ishte një frymëzim që Allahu ia zbriti Musait. Këto ishin shpifjet e tyre me të cilat ata i mohonin Cilësitë e Allahut dhe pretendimin e tyre se Allahu nuk flet dhe se Kur'ani është i krijuar. Shiko për më tepër: *Dbikr Medhabibil-Firak* (fq. 132-138).

bidatçi i devijuar. Ai nuk meriton që të dëgjohej dhe as nuk duhet të debatohet me të për ato çfarë thotë ai.”

Dhe pasi përmendi ateistin (*mulhid*), mexhusiun dhe njerëzit e sekteve të tjera, ai tha: “Futja në debate me ta përmban një dëm shumë të madh ngase ata do t’i përhapin dyshimet e tyre mes njerëzve; dhe ka të mundur që ai i cili hyn në debat me ta nuk do të jetë i aftë që t’i zgjidhë dyshimet e tyre.”

[10] *Nuk ka problem nëse u përmendet Njerëzve të Thjeshtë gjendja e Njerëzve të Bidatit dhe diçka rreth devijimit të tyre, derisa të paralajmërohen që të ruhen prej tyre:*

Tha Imam es-Sixhzi - *rahimebullab* - (fq. 195): “Studimi i nëntë është rreth përmendjes së disa gjërave nga deklaratat e tyre në mënyrë që njerëzit e thjeshtë t’i kenë ato plotësisht të qarta. Kjo do t’i bëjë ata që të largohen nga njerëzit e bidatit e të mos bien në kurthet e tyre.”

[11] *Çdo Bidatçi ka një përfundim ku çështja e tij del në shesh, pak rëndësi ka se sa kohë arrin ai që të qëndrojë i fshehur, ndryshe nga Ndjekësit e Gjurmëve të Selefëve (Ehlul-Ether):*

Tha Imam es-Sixhzi - *rahimebullab* - (fq. 195): “Dhe çdo kundërshtar i Sunetit dhe rrugës së Ehlul-Ether ka diçka që do ta nxjerri në shesh atë, po të mendosh. Kurse Ehlul-Ether nuk kanë asnjë skandal për të cilin ata duhet të nxirren në shesh sepse ata nuk kanë shpikur asgjë. Ata ndjekin vetëm gjurmët (*ether*). Dhe kushdo që pretendon se në *ethere* ka ndonjë skandal, megjithëse ai është gjykuar si i saktë (*sabijh*), atëherë ai nuk duhet konsideruar Musliman.”

[12] *Nga Kurthet e Njerëzve të Bidatit është Sjellja e tyre gjoja ata pajtohen me Ehli-Sunetin, i lavdërojnë ata dhe e mohojnë atë çfarë u është mveshur atyre - derisa njerëzit të bien në Kurthet e tyre:*

Tha Imam es-Sixhzi - *rahimebullab* - (fq. 200-201): “Dhe gjithashtu, këtu përfshihet edhe fshehja e medh’hebit nga disa njerëz dhe shfaqja e tij tek disa të tjerë. Ky është një përngjasim me *zindikët*<sup>8</sup>. Dhe nëpërmjet kësaj praktike ata depërtojnë tek shumë nga njerëzit e thjeshtë dhe ata që janë fillestarë në medh’hebi ne tyre, sepse në fillim ata shtiren sikur pajtohen dhe e mohojnë atë që u mvishet atyre (Ehli-Sunetit), derisa t’i fusin ata në grackë. Dhe kur ai bie në grackë, ata e tërheqin ataë pak e nga pak, derisa ai të shkëputet plotësisht nga Suneti.”

[13] *Nga Metodatat e Njerëzve të Bidatit në Largimin e njerëzve nga e Vërteta është se ata e akuzojnë Ehli-Sunetin për Sharje të Dijetarëve dhe përhapje të gënjeshtreve kundër atyre që i kundërshtojnë:*

Tha Imam es-Sixhzi - *rahimebullab* - (fq. 202): “Dhe prej saj është edhe ajo çfarë kanë bërë njerëzit e tyre në këtë kohë, veçanërisht ata të cilët janë të huaj në rradhët e tyre. E kjo është, se ata akuzojnë çdokënd që i kundërshton ata për sharjen e Dijetarëve me qëllim që t’i bëjnë zemrat e njerëzve që të hidhen kundër tij. Ata i mveshin atij fjalë të ndyra të cilat ai nuk i ka thënë e as nuk i beson; kjo është një shpifje dhe një gënjeshtër që vjen nga ata, sepse në shpifjet e gënjeshtërave e tyre nuk ka ndonjë gjë të neveritshme sipas logjikës; neveria e tyre njihet vetëm nëpërmjet teksteve (të Kur’anit dhe Sunetit). Dhe sipas tyre, kushdo që flet me diçka tjetër në vend të atyre çfarë thonë ata, atëherë ai është i devijuar dhe asgjë nuk është e ndaluar në lidhje me ta.”

[14] *Njerëzit e Bidatit janë nga Imamët e Dalaletit (devijimit):*

Tha Imam es-Sixhzi - *rahimebullab* - (fq. 216): “Ndërsa Imamët e Dalaletit (humbjes) janë mushrikët, ata të cilët pretendojnë (vetëm) Rububijen - si dhe munafikët. Pastaj, prej tyre është edhe çdokush që ka shpikur një Bidat në Islam, ka nxjerrë një rrugë që bie në kundërshtim me hadithin, çështjen e besimit ia ka nënshtruar logjikës së tij, ka mësues të cilët nuk njihen si ndjekës të gjurmëve të Selefëve, nuk e merr Sunetin nga ata që e pasojnë atë ose e merr Sunetin prej tyre por më pas e kundërshton atë.”

---

<sup>8</sup> **Sh.p:** *Zindikët* quhen mosbesimtarët që hiqen si Muslimanë me qëllim që të depërtojnë ndër rradhët e Muslimanëve dhe pastaj t’i shkatërrojnë ata dhe Fenë e tyre nga përbrenda.

[15] *Ndjekësi i Gjurmëve të Selefëve duhet të Nderohet dhe të Respektohet edhe nëqoftëse ai është i ri dhe nuk ka prejardhje fisnike; ndërsa Kundërshtari duhet të Poshtërohet edhe nëqoftëse ai është i Vjetër në moshë dhe ka Prejardhje Fisnike:*

Tha Imam es-Sixhzi - *rahimebullah* - (fq. 231-234): “Kështu që, është obligim që t’i jepet përparësi dhe të nderohet Ndjekësi i Gjurmëve të Selefëve edhe nëqoftëse ai është i ri në moshë dhe nuk ka prejardhje fisnike. Dhe duhet patjetër që të qëndrohet larg kundërshtarit edhe nëqoftëse ai është i vjetër në moshë dhe ka prejardhje fisnike.”

[16] *Paralajmërim që të mos bazohesh tek Çdo Libër dhe tek Çdo Person; Paralajmërim kundër Librave të Bidatçijve dhe Refuzim ndaj atij që thotë: “Merr prej tyre të Vërtetën dhe Lëre të Pavërtetën”:*

Kur Imam es-Sixhzi përfundoi një kapitull rreth kësaj çështjeje, ai tha (fq. 231-234): “Kapitulli 21 ka të bëjë me paralajmërimin që të mos bazohemi tek çdo person dhe të mos marrim nga çdo libër, ngaqë mashtrimet janë shtuar shumë dhe është përhapur tej mase mbështetja në medh’hebe. Dije - Allahu dhëntë Mëshirën e Tij mbi ne dhe ju - se ky kapitull është nga kapitujt e parë, të cilët do arrijnë ta ndalojnë këtë fatkeqësi në përgjithësi dhe çdo gjë që u ka rënë njerëzve për shkak të mosvëmendjes së tyre. Kjo për shkak se gjendja e njerëzve në kohën tonë është bërë e paqëndrueshme dhe ata që u mbështeten atyre (medh’hebeve) kanë fituar autoritet. Ata që e shesin Fenë e tyre për një ofertë të thjeshtë apo që duan të duken janë shtuar shumë; dhe është përhapur tej mase mbështetja në medh’hebe. Kështu, detyra e çdo Muslimani që e do sinqeritetin është se ai nuk duhet t’ia lëshojë frenat e tij çdo njeriu që nga pamja e jashtme të lë përshtypjen sikur pajtohet me të... Dhe kushdo që dëshiron të shpëtojë nga këta njerëz dhe të jetë i ruajtur nga epshet, atëherë le të jetë peshorja e tij Kur’ani dhe gjurmët (*etheret*) për çdo gjë që dëgjon dhe shikon. Kështu, me anë të këtyre të dyjave ai do të jetë i vetëdijshëm për nderin që fiton në sajë të tyre dhe nga pasimi i Selefëve. Dhe asnjë thënie nuk do të pranohet nga ndonjë njeri pa i kërkuar atij një ajet të qartë, apo një hadith të saktë, ose një deklaratë nga ndjekësit e Rrugës së Saktë... Kështu që, ruhuni nga

librat e atyre, gjendja e të cilëve ka ndryshuar tashmë, ngase në këto libra ka akrepa dhe ndoshta është e vështirë të gjendet ndonjë antihelm për helmin e tyre.”

[17] *Nga Kurthet e Njerëzve të Bidatit është Fshehja pas Dashurisë për Imamët e Sunetit në mënyrë që Njerëzit t`i pranojnë Bidatet e tyre:*

Tha Imam es-Sixhzi - *rahimebullab* - (fq. 231): “Vërtet, më ra në dorë një broshurë të cilën e kishte shkruajtur një burrë nga populli i Asbahanit, i njohur ndryshe si Ibnul-Leban, i cili ka jetuar mbas asaj që kam përjetuar unë. Ai e quajti këtë broshurë “*Sherh Mekaletul-Imamil-Euhad Ebi ‘Abdullah Ahmed Ibn Mubamed Ibn Hanbel’*” dhe në të përmendte medh’hebin e Esh’ariut, i cili kundërshtonte Ahmedin. Ai i dha një kopje të këtij libri një grupi njerëzish të cilët e qarkulluan në të gjithë vendin dhe thonin se ky është një Imam nga shokët e Ahmedit, *rahimebullab*. Dhe vërtet, ai i shpjegoi deklaratat e tij në mënyrë që njerëzit t’i shkruanin ato. Ata i zunë besë autorit dhe kështu ranë në devijim. Ky njeri ishte përzënë nga Bagdadi për këtë arsye prandaj ai u vendos në Asbahan.”

[18] *Kushdo që Lavdëron, Nderon dhe Respekton Njerëzit e Bidatit dhe Shan Ehli-Sunetin, atëherë ai është një Bidatçi edhe nëse ai shfaq Sunetin dhe Selefizmin në pamje të jashtme:*

Tha Imam es-Sixhzi - *rahimebullab* - (fq. 232): “Këtu në Mekke ne kemi një burrë i cili merret me hadithin dhe kalon pjesën më të madhe të kohës duke u çjerrë se ai nuk është Esh’ari. Pastaj ai thotë: “Unë kam parë njerëz fisnikë në rradhët e tyre dhe kam parë (njerëz nga Esh’aritë) që pluhuri nën këmbët e tyre është më fisnik sesa gjithë njerëzimi.” Dhe kur mbërrin në qytet ndonjë burrë nga Esh’aritë, ai i shkon nga pas dhe i afrohet atij. Dhe nëse atij do i shkonte ndonjë nga shokët tanë, ai qëndronte larg prej tij dhe i paralajmëronte të tjerët që të qëndronin larg prej tij. Saherë që ndonjë nga Dijetarët e Hanbelive përmendej në prani të tij, ai zbulonte gabimet e tij dhe thoshte: “Ahmedi është fisnik, por ai ka rreth vetes njerëz që gënjejnë.” Ky ishte kurthi i tij: ai nuk solli ndonjë fatkeqësi përveç se nëpërmjet këtij kurthi.”

[19] *Nga Metodat e Njerëzve të Bidatit për t`i Larguar Njerëzit nga Dijetarët është Sharja e Studentëve të tyre dhe Prishja e Imaxhit të tyre:*

Tha Imam es-Sixhzi - *rabimebullab* - (fq. 232-233) ndërsa përmend një nga Esh'aritë: "Saherë që ndonjë nga Dijetarët e Hanbelive përmendej në prani të tij, ai zbulonte gabimet e tij dhe thoshte: "Ahmedi është fisnik, por ai ka rreth vetes njerëz që gënjejnë." Ky ishte kurthi i tij: ai nuk solli ndonjë fatkeqësi përveç se nëpërmjet këtij kurthi. Kështu që, nëse është e lejuar që thuhet se shoqëruesit e Ahmedit kanë gënjyer në emër të tij në shfaqjen e medh'hebit të tij, atëherë do të ishte e saktë që të thuhej e njëjta gjë edhe për shoqëruesit e Malikut, Shafi'ut dhe atyre të tjerëve se edhe ata paskan gënjyer në ato çfarë transmetuan prej tyre. Dhe këtë nuk e thotë askush përveç se një injorant që nuk ka seriozitet në Fenë e tij dhe nuk ka asnjë fije turp."

[20] *Shumë nga ata që hyjnë mes Ehli-Sunetit në të vërtetë janë nga Njerëzit e Bidatit, të cilët duan t`i humbin e t`i devijojnë ata nga Suneti:*

Tha Imam es-Sixhzi - *rabimebullab* - (fq. 233): "Dhe mes njerëzve ka të atillë që në pamje të jashtme i refuzojnë Esh'aritë, e pastaj thonë: "Unë nuk flas lidhur me Shkronjat (*el-Harf*) dhe Zërin (*es-Seut*)." Dhe për njëjti të tillë, çështja e tij nuk do të jetë e pastër nga dy këndvështrime:

1- ose ai nuk ka përvojë rreth medh'hebit të atyre që ndjekin Gjurmët e Selefëve (*Ehlul-Ether*), por megjithatë ai do që të fitojë njohuri dhe dashuri duke e shfaqur haptazi atë,

2 - ose ai është në të vërtetë nga bidatçijtë, por që nga pamja e jashtme ai i refuzon ata në mënyrë që t'i mbulojë deklaratat e tyre me atë çfarë thotë për ta. Dhe kështu, atij i pranohet kjo gjë, ose poshtërsia e tij do të duket e mirë. Atëherë, njerëzit e ndjekin atë pasi ata mendojnë se ai i kundërshton bidatçijtë. Dhe sa të shumë janë ata që kanë dalë nga Ehli-Suneti në këtë mënyrë."



[21] *Justifikimi për Dijetarin Sunnij i cili lavdëron një Bidatçi është se ai nuk është njoftuar për medh`hebin e tij dhe nuk i ka studiuar mendimet e tij dhe kjo nuk është sharje për atë Dijetar:*

Tha Imam es-Sixhzi - *rahimehullab* - (fq. 227) ndërsa flet rreth Imam Ibn Ebi Zejdit, Imam el-Kabisit dhe argumentit që përdorin Esh'aritë se këta dy Imamë e kanë përmendur Ebul-Hasen el-Esh'arin si Imam: “Kështu pra, na bëhet e qartë nga ajo që thamë se nëse këta dy Dijetarë (*rahimehum Allah*) e kanë thënë atë çfarë thonë ata në lidhje me pozitën e Imamit që ka el-Esh'ari, atëherë, ata e thanë këtë gjë vetëm për të mbajtur një mendim të mirë për të dhe për shkak se ai në pamje të jashtme i refuzonte Mu'tezilët dhe Rafidët. Por, ata nuk ishin në dijeni rreth medh`hebit që kishte ai vetë. Dhe nëse ata do ta kishin ditur se kush ishte medh`hebi i tij, ata nuk do ta kishin thënë atë çfarë kanë thënë.”

[22] *Shëtegu i Shpëtimit nga Epshet e Refuzuara:*

Tha Imam es-Sixhzi - *rahimehullab* - (fq. 233-234): “Dhe kushdo që dëshiron të shpëtojë nga këta njerëz dhe të jetë i ruajtur nga epshet, atëherë le të jetë peshorja e tij Kur'ani dhe gjurmët (*etheret*) për çdo gjë që dëgjon dhe shikon. Kështu, me anë të këtyre të dyjave ai do të jetë i vetëdijshëm për nderin që fiton në sajë të tyre dhe nga pasimi i Selefëve. Dhe asnjë thënie nuk do të pranohet nga ndonjë njeri pa i kërkuar atij një ajet të qartë, apo një hadith të saktë, ose një deklaratë nga ndjekësit e Rrugës së Saktë. Kështu që, shikoni sa më shumë në librat e Sunetit që kanë shkruajtur ata të cilëve u janë dhënë grada të larta, si: Ebi Davud es-Sixhistani, ‘Abdullah Ibn Ahmed Ibn Hanbel, Harb Ibn Isma’il es-Sejrxhani, Khashijsh Ibn Efram en-Nisa’i, ‘Uruetu Ibn Meruan er-Raki dhe ‘Uthman Ibn Se’id ed-Darimi es-Sixhistani. Dhe ruhuni nga librat e atyre, gjendja e të cilëve ka ndryshuar tashmë, ngase në këto libra ka akrepa - dhe ndoshta është e vështirë të gjendet ndonjë antihelm për helmin e tyre.”

Lavdia i takon vetëm Allahut; salati dhe selami qoftë mbi të  
Dërguarin e Allahut, mbi Familjen e tij, Shokët e tij,  
dhe të gjithë ata që i bashkangjiten atij.

Përktheu: Alban Malaj  
Burimi: [SunnahPublishing.net](http://SunnahPublishing.net)